

URDHËR
Nr. 125, datë 12.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Departamentit të Administratës Publike, z. Ened Kërçini, drejtor i Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike, në Departamentin e Administratës Publike.
 2. Delegimi i kompetencave fillon për periudhën nga data 12.9.2023 deri në plotësimin e pozicionit të drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, sipas procedurave ligjore.
 3. Për realizimin e kompetencave në pozicionin e drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, z. Kërçini ka të drejtë të kryejë çdo veprim të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
 4. Ngarkohet z. Ened Kërçini, drejtor i Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike, në Departamentin e Administratës Publike, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama